



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA/ REPUBLIC OF KOSOVO
KOMUNA E GJAKOVËS
OPŠTINA DJAKOVICA/MUNICIPALITY OF GJAKOVA



Njësia e Prokurimit

Gjakovë, datë 15.09.2023

Zyrtari Përgjegjës i Prokurimit i Komunës së Gjakovës, në mbështetje të nenit 108/A (paragrafi 10.2) të Ligjit mbi Prokurimin Publik nr. 04/L-042, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092, duke u bazuar në nenin 63 (paragrafi 63.1.3) të Rregullores për Prokurim Publik /Nr.001/2022, të publikuar nga Komisioni Rregullativ i Prokurimit Publik, duke vendosur sipas kërkesës për ri-shqyrtim të datës 12.09.2023, të parashtruar nga Operatori Ekonomik “**Internat Security Association**”SH.P.K lidhur me aktivitetin e prokurimit me “**Ri-Tender-Sigurimi fizik i objekteve të Komunës së Gjakovës**”, Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-23-7911-2-1-1, Nr. i brendshëm-632-23-059 -211, **nxjerr:**

V E N D I M

- 1. Refuzohet** si e pabazuar kërkesa për ri-shqyrtim të Operatorit ekonomik: “**Internat Security Association**”SH.P.K, e dt.12.09.2023, lidhur me aktivitetin e prokurimit me titull: “**Ri-Tender-Sigurimi fizik i objekteve të Komunës së Gjakovës**”, Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-23-7911-2-1-1, Nr. i brendshëm-632-23-059 -211, kundër Dosjes së tenderit dhe Njoftimit për kontratë te AK –së, të datës 18.08.2023, të publikuar në platformën elektronike të KRPP-së.
- 2. Vërtetohet DOSJA E TENDERIT DHE NJOFTIMI PËR KONTRATË** me përmirësimet e publikuara me datë: 18.08.2023;
3. Autoriteti Kontraktues, vendos që të vazhdoj aktivitetin e prokurimit.
4. Ky vendim hyn në fuqi ditën e nënshkrimit dhe publikohet në platformën elektronike të KRPP-së .

A r s y e t i m

Operatori Ekonomik “**Internat Security Association**”SH.P.K. me dt.12.09.2023, ka parashtruar kërkesës për ri-shqyrtim , lidhur me aktivitetin e prokurimit “**Ri-Tender-Sigurimi fizik i objekteve të Komunës së Gjakovës**”, Nr. i prokurimit- Nr. i prokurimit- 632-23-7911-2-1-1, Nr. i brendshëm-632-23-059 -211.

Autoriteti Kontraktues Komuna e Gjakovës, me datë 15.09.2023, ka shqyrtuar kërkesën në fjalë si më poshtë:

Pretendimi juaj është i pabazuar, sepse paga nuk është e cekur me vlerë, andaj çështja e caktimit të vlerës së pagave është çështje e fuqisë së tregut.

Zyrtari Përgjegjës i prokurimit bazuar ne ato që u thane më lart ka vendosur si në dispozitiv.

Këshilla juridike:

Kundër këtij vendimi, ankuesi mund të paraqesë ankesë pranë OSHP-së . **Ankesa pranë OSHP-se duhet te dorezohet brenda 10 (dhjete) diteve pas pranimit te ketij vendimi.**

Faton Gutaj

Menaxher i Zyrës së Prokurimit



Kopje: Operatorit Ekonomik;
Zyrës së Kryetarit të Komunës;
Te gjitha palëve të interesuara;